

ABSTRAKT

i punimit të masterit “Dukuria e terrorizmit në instrumentet juridike të OKB-së”

Përmes punimit të masterit me titull: “Dukuria e terrorizmit në instrumentet juridike të OKB-së”, synohet t’i bëhet një studim specifikave të terrorizmit, transformimit të tij nëpër periudha të ndryshme historike me theks të posaçëm në periudhën bashkëkohore, formave të paraqitjes së tij, e në veçanti analizimit dhe studimit të akteve dhe instrumenteve të ndryshme ndërkombëtare me të cilat rregullohet dhe përcaktohet luftimin dhe ndëshkimi i akteve terroriste.

Në fushën e parandalimit dhe luftimit të terrorizmit, primare është bashkëpunimi ndërmjet organeve kompetente nacionale dhe ndërkombëtare, pikërisht në një numër të madh të konventave ndërkombëtare të OKB-së, të analizuar gjatë dhe për nevojat e këtij studimi përcaktohet dhe rregullohet kjo çështje, andaj trajtimi dhe publikimi i tyre në masë të konsiderueshme kontribuon në informimin dhe vetëdijesimin e opinionit të gjerë lidhur me to e në veçanti të të rinjve, studentëve të drejtësisë dhe studiuesve të tjerë sikurse të terrorizmit ashtu edhe të mekanizmave dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në tërësi.

Me përdorimin e metodës analitike-pozitive në këtë punim, i është bërë analiza shkencore dhe juridike e konventave të ndryshme ndërkombëtare, duke filluar nga Konventa e Gjenevës e vitit 1937 e deri te konventat dhe protokollet e OKB-së të fillimit të shekullit XXI. Ndërsa përmes metodës krahasuese (komperative) është bërë krahasimi i dispozitave të ndryshme të Konventave të OKB-së të cilat rregullojnë forma të caktuara të akteve terroriste. Në veçanti kjo metodë është përdorur për krahasimin e konventave dhe protokolleve të ndryshme të OKB-së, e të cilat objektin e trajtimit e kanë të njëjtë, por të cilat me qëllim të rregullimit të inkriminimit të formave rishtas të paraqitura të terrorizmit, kanë plotësuar dhe ndryshuar konventat paraprake.

Përveç me akte regjionale, terrorizmi është trajtuar edhe me aktet e OKB-së, organizatë kjo e cila duke filluar nga viti 1963 e deri me sot ka aprovuar 19 instrumente juridike ndërkombëtare për të parandaluar dhe luftuar aktet terroriste. Duke marrë për bazë sferën e terrorizmit që trajtohet në instrumentet juridike të OKB-së, në përgjithësi ato mund të ndahen, në katër grupe të mëdha: a) lidhur me aviacionin civil; b) lidhur me lundrimin detar; c) lidhur me mbrojtjen e stafit ndërkombëtar nga terrorizmi, marrjen e pengjeve dhe financimin e terrorizmit dhe d) lidhur me eksplozionet terroriste; materialet shpërthyes dhe bërthamore, si dhe terrorizmin bërthamor.